



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacije
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Inovation

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINTI) Nr. 03/2026
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MTI) Nr.
04/2019 PËR CAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PËRDORIMIT TË
LOGOS TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS DHE
SIMBOLIT TË AKREDITIMIT DHE REFERIMI I TEKSIT NË AKREDITIM

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

Në mbështetje të Nenit 27 të Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 30 dhe nenit 31 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINTI) Nr. 03/2026
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MTI) Nr.
04/2019 PËR CAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PËRDORIMIT TË
LOGOS TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË KOSOVËS DHE
SIMBOLIT TË AKREDITIMIT DHE REFERIMI I TEKSIT NË AKREDITIM**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 për caktimin e formës , përmbajtjes dhe përdorimit të logos të drejtorisë së përgjithshme të akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim.

Neni 2

Teksti i shtojcës së dytë (2) riformulohet me tekstin si në vijim:

Shtojca 2: Simboli i akreditimit

Simboli i akreditimit është i përbërë nga logoja e DAK-ut, i kombinuar me:

2.1. Për trupat e akredituar për një skemë akreditimi me identifikimin e skemës së akreditimit dhe numrin e akreditimit të trupit të vlerësimit të konformitetit.

2.2. Për trupat e akredituar për më shumë se një skemë akreditimi me identifikimin e skemave të ndryshme të akreditimit dhe numrin e akreditimit të trupit të vlerësimit të konformitetit.

Neni 3

Në shtojcën 2 të Udhëzimit bazë, tek tabela Simboli i akreditimit, shtohen 2 Simbole të akreditimit me tekstin dhe dukjen si në vijim:

Simboli i akreditimit	Shpjegim
	Simboli i akreditimit për laboratorët mjekësor të akredituar sipas SK ISO 15189. 000-Numri i akreditimit
	Simboli i akreditimit për trupa certifikues të akredituar. 000-Numri i akreditimit

Neni 4

Tabela ku prezentohet Simboli i kombinuar i akreditimit me ngjyre dhe bardhe e zi është fshirë në tërësi.

Neni 5

Ky udhëzim është pjesë përbërëse e Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 20. 07. 2026

Minjoza KUSARI LILA

Ministre në detyrë

